

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH

Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	10	Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No:	05-6175
Nr.i faqëve Br.stranica No.pages	-4-	Data: Datum:	14.09.2018

Prishtinë / a

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo  
ODA E FARMACISTEVË TË KOSOVËS  
KOMORA FARMACEUTA KOSOVA  
PHARMACIST'S CHAMBER OF KOSOVA

Nr.Br.No. 115 Di 14.09.2018  
Prishtinë



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA – VLADA – GOVERNMENT  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO  
ZDRAVSTVA - MINISTRY OF HEALTH  
Inspektorati Farmaceutik/Farmaceutski  
Inspektorat/Pharmaceutical Inspectorate

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
ODA E FARMACISTEVË TË KOSOVËS  
Komora Farmaceuta Kosova  
Kosova Chamber of Pharmacists

Palët në këtë memorandum:

**ODA E FARMACISTEVË TË KOSOVËS** (në vazhdim nën akronim OFK) me seli në adresë Rr. Kosta Novakoviç p.n. Kontenieri III, zyra nr. 214, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Kryetari i OFK-së, Dr. Arianit Jakupi;

dhe

**INSPEKTORATI FARMACEUTIK** (në vazhdim nën akronim IF) me seli në adresë Rr. e Zagrebit, (Objekti i Ministrisë së Shëndetësisë) p.n., 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga U.D. Drejtor, Dr. Shaban Osmanaj;

*Me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellë institucional, për të siguruar një mbikëqyrje dhe zbatim të legjislacionit në fuqi,*

*Përmes bashkëpunimit të ndërsjellë për të siguruar integritetin profesional të farmacistit dhe teknikut të farmacisë si profesionist shëndetësor,*

*Me angazhim për të dhënë kontributin në forcimin institucional të sistemit shëndetësor në interes të përgjithshëm të qytetarëve të Republikës,*

*Për veprime konkrete institucionale të bazuara në legjislacionin në fuqi duke vënë në qendër të vëmendjes pacientin.*

Palët në këtë memorandum dakordohen si në vijim:

## **Neni 1.**

### **Qëllimi**

1. Ky Memorandum synon zhvillimin e bashkëpunimit të ngushtë midis palëve në memorandum, duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësit ligjore që kanë.
2. Ky Memorandum ka për qëllim veçanërisht ngritjen e nivelit të veprimtarisë dhe aktiviteteve përkitazi me shëndetin publik në institucionet publike dhe private Farmaceutike në Republikën e Kosovës.

## **Neni 2.**

### **Përkufizimet**

1. Termet dhe akronimet e përdorura, në kuptimin e këtij Memorandumi kanë këtë domethënie:
  - 1.1 **Nivelet e kujdesit shëndetësor** – përfshinë tri nivelet e kujdesit shëndetësor siç është përkufizuar me Ligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësinë;
  - 1.2 **Ministria** - Ministria e Shëndetësisë;
  - 1.3 **Kompetencat publike** – nënkupton kompetencat ligjore që i janë besuar odave të profesionistëve shëndetësor me Ligjin Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor;
  - 1.4 **Inspektimi Farmaceutik** – i përcaktuar me Ligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale Nr. 04/L-190

## **Neni 3.**

### **Fusha e bashkëpunimit**

1. Palët dakordohen që të angazhohen për nevojat e veprimtarisë së tyre në këto çështje:
  - 1.1 Kontaktet e vazhdueshme në mes të OFK-së dhe IF-së lidhur me zbatimin e Ligjit për Shëndetësinë, Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore me qëllim të bashkërendimit institucional dhe ngritjes së kujdesit shëndetësor ndaj qytetarëve në institucioneve farmaceutike shëndetësore
  - 1.2 Këshillimi i ndërsjellët lidhur me çështjet profesionale për veprimtaritë farmaceutike shëndetësore me qëllim të zbatimit të legjislacionit, standardeve ligjore dhe profesionale përkitazi me shërbimin në nivelet e kujdesit shëndetësor farmaceutik në tërë territorin e Republikës së Kosovës;
  - 1.3 Sigurimi i informacioneve të nevojshme për metodologjinë e arritjes së standardeve përkatëse nga veprimtaria mjekësore;
  - 1.4 IF-ja përgjatë veprimtarisë inspektuese do të referojë rastet e shkeljeve të etikës profesionale dhe deontologjisë mjekësore pranë organeve kompetente të OFK-së.
  - 1.5 IF – ja do të vërtetojë faktin juridik të përmbushjes së detyrimit ligjor të anëtarësisë së farmacistëve në OFK duke marrë parasysh detyrimin nga Neni 8 i Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor;

- 1.6 OFK-ja do t'i ofrojë IF-së të gjitha informatat që i ka në dispozicion për anëtarësinë dhe të licencuarit e saj lidhur me nevojat e inspektimit shëndetësor; dhe
  - 1.7 IF-ja do të informojë OFK – në për të gjitha gjetjet e parregullsive lidhur çështjet e kompetencave publike të OFK – së, sidomos përkitazi me ushtrimin e veprimtarisë së palicencuar, çështjet që ndërlidhen me aftësimin specialistik dhe çështjeve të tjera që janë në interes të OFK-së nga fusha e kompetencave publike.
2. Palët e këtij memorandum do të ndërmarrin veprimet e përshtatshme për nevojat e cekura në paragrafin 1 të këtij neni, sipas mënyrës së përkufizuar në këtë nen të këtij Memorandumi.

#### **Neni 4.**

#### **Metodologjia e bashkëpunimit**

1. Me qëllim të realizimit të bashkëpunimit të ndërsjellë, palët dakordohen që bashkëpunimin e përcaktuar në nenin 3 të këtij memorandum ta realizojnë përmes:
  - 1.1 Takimeve të thirrura nga cilado palë në bazë të nevojës në mes të përfaqësuesve të OFK-së dhe përfaqësuesve të IF-së;
  - 1.2 Themelimit të grupeve punuese për përpilimin e dokumenteve të ndryshme strategjike dhe operative që kanë të bëjnë me implementimin e fushave të bashkëpunimit të përcaktuar në nenin 3 të këtij memorandum; dhe
  - 1.3 Bashkëpunimit për nismat e përbashkëta për realizimin e projekteve specifike.
  - 1.4 Zyrtarët nga IF në bazë të këtij memorandum mund të marrin pjesë në grupet dhe komisionet punuese të OFK-së, me kusht të shmangies të konfliktit të interesit të secilit rast specifik në të cilin personalisht ka qenë i përfshirë.
2. Për çfarëdo nevoje lidhur me praktikat e bashkëpunimit, palët në këtë memorandum do të bashkërendojnë veprimet e tyre me qëllim të arritjes së objektivave të shprehura në këtë memorandum.

#### **Neni 5.**

#### **Mënyra e komunikimit**

1. Palët dakordohen që për çdo çështje të kontaktojnë përmes zyrtarëve të autorizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Palët do t'ia caktojnë zyrtarët e tyre për komunikim të ndërsjellë përmes shkresës zyrtare të autorizuar nga udhëheqësit e institucioneve përkatëse.
2. Komunikimi në mes të zyrtarëve të autorizuar do të realizohet, por nuk do të kufizohet, përmes takimeve të drejtpërdrejta si dhe përmes komunikimit formal përmes postës dhe komunikimit elektronik.
3. Adresat zyrtare të komunikimit janë:
  - 3.1 **Oda e Farmacistëve të Kosovës (OFK) - E-mail: [info@ofk-rks.net](mailto:info@ofk-rks.net) nr. tel. 045 – 909 - 699**

3.2 Inspektorati Farmaceutik : E-mail: shaban.osmanaj@rks-gov.net nr.  
tel.03820024126

**Neni 6.**  
**Hyrja në fuqi**

Memorandumi i mirëkuptimit në mes të Odës së Farmacistëve të Kosovës dhe Inspektoratit Farmaceutik hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

**Vendi: Prishtinë**  
**Data: 13 Shtator 2018**

**PALËT NËNSHKRUESE**


---

Oda e Farmacistëve të Kosovës

Dr. Arianit Jakupi  
Kryetar i OFK-së


---

Inspektorati Farmaceutik

U.D. Dr Shaban Osmanaj  
Drejtor i IF



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government  
Fondi i Sigurimeve Shëndetësore



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Oda e Farmacistëve të Kosovës  
Komora Farmaceuta Kosova  
Chamber of Pharmacists of Kosovo  
Nr.Br.No. 53 Dt 23.09.19



ODA  
E FARMACISTËVE  
TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR FOND ZA ZDRAVSTVENO OSIGURANJE HEALTH INSURANCE FUND	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit.	FSSH
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	2056
Nr. I faqave Br. I strana No. pages	-4-
Data Datum Date	2009,19
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA	

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

### FONDIT TË I SIGURIMEVE SHËNDETËSORE

dhe

### ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS

**PASI QË** Fondi i Sigurimit Shëndetësor (në tekstin e mëtejshëm: 'FSSH') dhe Oda e Farmacistëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "OFK") janë dakorduar për këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (në tekstin e mëtejshëm 'marrëveshja').

**DUKE QENË SE** FSSH dhe OFK (më tej referohen bashkërisht si "palët") kanë qëllime të ngjashme, në sigurimin e kujdesit shëndetësor dhe shërbime tjera të ndërlidhura në nivel më të lartë dhe më kualitativ, si dhe për të mbështetur arritjen e objektivave sektoriale duke vendosur standard në ofrimin e kujdesit shëndetësor në Republikën e Kosovës;

**SI RRJEDHOJË**, palët kanë rënë dakord të forcojnë bashkëpunimin e tyre në bazë të kësaj marrëveshje bashkëpunimi dhe të vendosin kornizat e bashkëpunimit për zbatimin e plotë të këtij marrëveshje.

#### 1. QËLLIMI

- 1.1 Qëllimi i marrëveshjes është ngritja e bashkëpunimit në mes të Palëve në çështjet me interes të përbashkët dhe me theks të veçantë në shkëmbimin e të dhënave ndërmjet Sistemit Informativ të FSSH-së ("SIF") dhe Sistemit Informativ të OFK.
- 1.2 Kjo marrëveshje përcakton kushtet nën të cilat palët mundësojnë shkëmbimin e të dhënave nga sistemet përkatëse.

## **2. FUSHËVEPRIMI**

- 2.1 Fushëveprimi i kësaj marrëveshje është dhënia e shënimeve për farmacistët e licencuar në OFK.
- 2.2 Leximi i të dhënave do të mundësohet në formë elektronike, përmes Ueb Shërbimeve ose përmes lidhjes së sistemeve me qasje vetëm nga përdorues të autorizuar.
- 2.3 Palët mund të hartojnë udhëzues (procedurë) për shkëmbimin e të dhënave përmes të cilëve do të definohet lloji i të dhënave të cilat do të shkëmbehen në nivel teknik të informatave.

## **3. RËNDËSIA**

- 3.1 Shkëmbimi i të dhënave të farmacistëve të licencuar është i një rëndësie të madhe për Sistemin e Informimit të Fondit, duke përfshirë edhe barnatoret dhe farmacistët e licencuar.
- 3.2 Të dhënat e farmacistëve të licencuar ndihmojnë në aktivizimin dhe pasivizimin automatik të qasjes në e-recetë në bazë të statusit të licencës së farmacistit.
- 3.3 Ofrimi i të dhënave të farmacistëve të licencuar ndihmon në procesin e kontraktimit të barnatoreve dhe identifikimit të saktë të farmacistëve.

## **4. MENYRA E SHKËMBIMIT TË TË DHËNAVE**

- 4.1 Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet palëve të përcaktuara me këtë Marrëveshje do bëhet në përputhje me Procedurën Standarde të Operimit (PSO), e cila i është bashkangjitur kësaj Marrëveshjeje dhe është pjesë integrale e saj.
- 4.2 PSO do të parasheh të gjitha procedurat se si do të bëhet shkëmbimi në mes palëve, do të definojë llojin e të dhënave të cilat do të shkëmbehen, shpeshtinë e shkëmbimit dhe aspekte të tjera teknike.

## **5. ZOTIMET E FSSH-së**

- 5.1. FSSH do të sigurojë teknologjinë e duhur që do të shfrytëzohet si urë lidhëse ndërmjet sistemeve.
- 5.2. FSSH zotohet të mbajë resurset në gjendje të qasshme dhe të përditësuar.
- 5.3. FSSH zotohet që të dhënat të cilat do të shfrytëzohen nga zyrtarët e saj të i nënshtrohen mekanizimeve të sigurisë dhe si të tilla do të përdoren vetëm për qëllime të këtij memorandumi dhe të njëjtat nuk do të shpërndahen për palë të tjera të paautorizuara.

## **6. ZOTIMET E OFK-së**

- 6.1. OFK do të sigurojë teknologjinë e duhur që do të shfrytëzohet si urë lidhëse ndërmjet sistemeve.
- 6.2. OFK zotohet të mbajë resurset në gjendje të qasshme dhe të përditësuar.
- 6.3. OFK pajtohet që të dhënat që janë në pronësi apo me të cilat disponon në lidhje me farmacistët e licencuar, të i vë në dispozicion të FSSH-së në kohe reale, përmes qasjes sipas mënyrës së përshkruar në PSO.
- 6.4. OFK -ja zotohet të njoftojë pa vonesë FSSH-në në rast të ndryshimit të çfarëdo të dhëne të kërkuar si me lart për farmacistët e licencuar.

## **7. RUAJTJA E INFORMATAVE TË Mbledhura dhe MBIKËQYRJA**

- 7.1. Palët pajtohen që të dhënat që do të shkëmbehen janë konfidenciale dhe si te tilla do të përdoren vetëm për qëllime të kësaj Marrëveshjeje dhe vetëm brenda kornizës së saj.
- 7.2. Përpunimi dhe përdorimi i të dhënave personale nga ky memorandum duhet të behet në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
- 7.3. Në rast të dyshimit për shkelje të sigurisë së informatave të çfarëdo forme, pala e dëmtuar duhet të njoftojë menjëherë palën tjetër dhe se të dy palët rezervojnë të drejtën për të ndërprerë përkohësisht shkëmbimin e të dhënave deri në sqarimin e situatës.

## **8. PËRGJEGJËSIA**

- 8.1. Për qëllimet e këtij marrëveshjeje, çdo Palë është Kontraktuese e pavarur. Asnjë Palë nuk do të ketë autorizime për të bërë ndonjë deklaratë, përfaqësim ose angazhim të çfarëdo lloji, ose për të ndërmarrë ndonjë veprim i cili do të jetë detyrues për Palën tjetër, me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht në këtë marrëveshjeje ose të autorizuar me shkrim nga Pala tjetër.
- 8.2. Secila Palë do të jetë përgjegjëse vetëm për mënyrën në të cilën ajo kryen pjesë të aktiviteteve të bashkëpunimit në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe/ose ndonjë marrëveshjeje tjetër. Pra, asnjëra palë nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë humbje, aksident, dëmtim që i është shkaktuar ose e ka shkaktuar pala tjetër, ose nga punonjësit, konsulentet ose nen-kontraktoret e palës tjetër, në lidhje me ose si rezultat i bashkëpunimit për realizmin e aktiviteteve sipas kësaj Marrëveshjejeje.

## **9. AFATI, NDËRPRERJA, AMANDAMENTIMI**

- 9.1. Kjo marrëveshje mbetet e vlefshme për një afat të pacaktuar.
- 9.2. Marrëveshja mund të ndryshohet me pajtim të ndërsjellët me shkrim të palëve. Palët mundën, me shkëmbim letrash, të ndryshojnë ndonjë nga dispozitat e kësaj

Marrëveshjeje ose të hyjnë në aranzhime plotësuese të përcaktuar me tej fushëveprimin e kësaj Marrëveshjeje.

## 10. ZBATIMI DHE HYRJA NË FUQI

- 10.1 Palët nënshkruese u pajtuan që kjo Marrëveshje të fillojë së zbatuari nga data e nënshkrimit.
- 10.2 Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, palët obligohen në zbatimin e plotë të saj.
- 10.3 Kjo Marrëveshje është e nënshkruar nga personat e autorizuar dhe është e hartuar në dy (2) kopje të njëjta, nga një (1) kopje për secilën nga palët nënshkruese.

Për: FSSH

Fatmir Plakiqi

Drejtor



---

Prishtinë

20 shtator 2019

Për: OFK

Arianit Jakupi

Kryetar



---







Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government  
Fondi i Sigurimeve Shëndetësore



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës  
Komora Farmaceuta Kosova  
Chamber of Pharmacists of Kosovo  
Nr.Br.No. 55 Dt 23.09.19



ODA  
E FARMACISTËVE  
TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR FOND ZA ZDRAVSTVENO OSIGURANJE HEALTH INSURANCE FUND	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit. <u>FSSH</u>	Nr. Prot. Broj Prot. <u>2057</u> Prot. No.
Nr. i faqeve Br-stranica <u>-4-</u> No. pages	Data Datum <u>20.09.19</u> Date
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA	

## PROCEDURË STANDARDE E OPERIMIT

në mes të

Fondit të Sigurimeve Shëndetësore (FSSH)

dhe

Odës së Farmacistëve të Kosovës (OFK)

## **1. QËLLIMI DHE NEVOJAT**

### **1.1 Nevojat operative për Procedurën Standarde të Operimit**

Duke pasur parasysh nevojën e institucioneve për të përmirësuar kualitetin e shënjimeve dhe për të ofruar shërbime sa më të mira, më të shpejta dhe më të sakta, ka lindur nevoja e vendosjes së bashkëpunimit në mes të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore (FSSH) dhe Odës së Farmacistëve të Kosovës (OFK). Oda e Farmacistëve të Kosovës posedon regjistrin e farmacistëve të licencuar i cili është i domosdoshëm për funksionimin e Sistemit të Informimit të Fondit, respektivisht e-recetës.

Ofrimi i të dhënave të caktuara për Sistemin e FSSH-së është me rëndësi pasi që i mundësohet kërkimi dhe identifikimi i saktë i të dhënave përkatëse përmes parametrave të caktuar.

### **1.2 Qëllimi për Procedurën Standarde të Operimit**

Qëllimi i kësaj procedure është trajtimi i kërkesave për të dhënat nga FSSH-ja drejt OFK-së, si në marrjen e të dhënave për një entitet ashtu edhe për verifikimin e të dhënave të entitetit.

Varësisht nga rasti që do të paraqitet për marrjen e të dhënave, do të caktohet mënyra e marrjes së shënjimeve. Me këmbimin e këtyre të dhënave në mes të këtyre dy institucioneve do të arrihet një besueshmëri për të dhënat që do të trajtohen.

FSSH dhe OFK do të sigurojnë zbatimin e dispozitave të fshehtësisë dhe mbrojtjes së të dhënave.

FSSH ka obligim që të dhënat të cilat i merr në bazë të marrëveshjes së arritur do t'i shfrytëzojë vetëm për qëllimin përkatës dhe nuk do t'i shpërndajë tek palët e pa autorizuara.

## **2. BAZA LIGJORE**

Të dy institucionet kanë mandat për të kërkuar të dhënat në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, marrëveshjen e bashkëpunimit, për qëllime të ligjshme dhe kryerjen e detyrave të tyre. Qëllimi i shkëmbimit të informacionit është për të rritur efikasitetin e punëve operative.

## **2.1 Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale**

Të dhënat që shkëmbehen duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, ku definohet përpunimi i të dhënave, të dhënat e ndjeshme personale, si dhe procedimi i këtyre të dhënave personale për rastet kur është e nevojshme.

Neni 2, paragrafët 1.2, 1.16 dhe 1.17 dhe neni 5 i Ligjit nr. 03/L-172 (2010) për mbrojtjen e të dhënave personale, përcaktojnë përpunimin e të dhënave personale, të dhënat e ndjeshme, kodin e identifikimit lidhës dhe bazën ligjore për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

## **2.2 Marrëveshja e Bashkëpunimit**

Kjo Procedurë Standarde e Operimit bazohet në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Fondit të Sigurimeve Shëndetësore dhe Odës së Farmacistëve të Kosovës.

## **3. SHKËMBIMI I TË DHËNAVE**

Me qëllim të eliminimit të procedimit të kërkesave për të dhëna përmes kopjeve fizike, gabimeve në shënime, ky dokument përcakton mënyrën e përpunimit, respektivisht qasjes në shënime në kohë reale, në shënime të sakta si dhe ofrimin e shërbimeve të lehtësuara si për zyrtarët e institucioneve ashtu edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim, ky dokument përshkruan strukturën e përgjithshme të automatizimit të procesit të marrjes së të dhënave të OFK-së për FSSH-në dhe anasjelltas nëse paraqitet nevoja.

### **3.1 Mënyra e shkëmbimit të të dhënave**

Të dhënat do të shkëmbehen përmes një baze të dhënash ndërmjetësuese, e cila është në MSSQL, versioni 2016 apo me i ri, me emrin FSSH, e cila nga ana e OFK do të popullohet me të dhëna të përditësuara sa herë që ka ndryshime në regjistrin e farmacistëve. Baza e të dhënave do të krijohet nga dhe në serverët e FSSH-së, kurse struktura e shënimeve është si më poshtë:

### FARMACISTI

1	ID	INT	NOT NULL
2	NUMRI_PERSONAL	VARCHAR(25)	NOT NULL
3	NR_LICENCES	VARCHAR(30)	NOT NULL
4	EMRI	VARCHAR(50)	NOT NULL
5	MBIEMRI	VARCHAR(50)	NOT NULL
6	DATA_LICENCES	DATETIME	NOT NULL
7	DATA_SKADIMIT	DATETIME	NOT NULL
8	AKTIV	BOOL	NOT NULL
9	INFO	VARCHAR(500)	NULL
10	DATA_KRIJIMIT	DATETIME	NOT NULL
11	PERDORUESI	VARCHAR(50)	NOT NULL

### GJURMA

1	ID	BigINT	NOT NULL
2	PËRDORUESI	VARCHAR(50)	NOT NULL
3	KLIENTI_IP	VARCHAR(50)	NOT NULL
4	KOHA	DATETIME	NOT NULL
5	NDRYSHIMI	VARCHAR(500)	NOT NULL

### **3.2 Ruajtja e gjurmëve gjatë shkëmbimit**

Të dy institucionet janë të obliguara që gjatë shkëmbimit të të dhënave të bëjnë ruajtjen e gjurmëve (*log-ave*), për secilin ndryshim që kryhet nga sistemet përkatëse. Tabela e gjurmëve duhet të mundësojë informatat së kush ka realizuar qasje, në cilën kohë dhe cilat informata janë kërkuar e të cilat duhet të jenë të auditueshme, çdo herë kur shihet si e nevojshme.

Për: FSSH

Fatmir Plaqiqi

Drejtör




Prishtinë

20 shtator 2019

Për: OFK

Arianit Jakupi

Kryetar





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës  
Komora Farmaceuta Kosova  
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 35 Dt 03.03.21



**ODA  
E FARMACISTËVE  
TË KOSOVËS**

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA



**ALMA MATER EUROPAEA CAMPUS  
REZONANCA, PRISHTINË-KOSOVË**

## **INSTITUTI PËR HULUMTIME DHE TRAJNIME NË SHKENCAT MJEKËSORE “REZONANCA”**

**Prishtinë**

Tel: +383 38 544-754

URL: <http://www.rezonanca-rks.com>

### **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

Palët e përfshira: “Oda e Farmacistëve të Kosovës” dhe Instituti për Hulumtime dhe Trajnime në Shkencat Mjekësore - “Rezonanca”

Data: 03.03.2021

Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet nga përfaqësuesit e institucioneve të lartpërmendura me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit për zhvillimin e hulumtimeve shkencore, organizimin e trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm profesional në fushën e shkencave farmaceutike.

#### **Fushat e bashkëpunimit**

Oda e Farmacistëve të Kosovës (OFK) dhe Instituti për Hulumtime dhe Trajnime në Shkencat Mjekësore Rezonanca dakordohen që të bashkëpunojnë në çështjet në vijim:

- Organizimin e konferencave, simpoziumeve dhe punëtorive
- Organizimin e hulumtimeve me fokus në shkencat farmaceutike
- Organizimin e trajnimeve profesionale në fushën e farmacisë
- Organizimin e fushatave me qëllim të vetëdijësimit të qytetarëve për ruajtjen e shëndetit
- Ofrimin e konsulencës profesionale dhe bashkëpunimin me organizma institucionale sipas marrëveshjeve përkatëse

### **Neni 1: Organizimi i aktiviteteve**

Çdo propozim për aktivitete duhet të aprovohet paraprakisht nga të dy institucionet. Pasi të pranohet propozimi, të dy institucionet caktojnë personat përgjegjës për zbatimin e aktivitetit.

Dy institucionet para zhvillimit të cilitdo aktivitet, fillimisht dakordohen për mënyrën e organizimit të aktivitetit, vendin dhe numrin e pjesëmarrësve, në përputhje me rregulloret e EVP-së dhe legjislacionin aktual.

### **Neni 2: Objektivat**

- Akreditimi i aktiviteteve për edukim të vazhdueshëm profesional
- Hulumtimet e përbashkëta në fushën e shkencave farmaceutike

### **Neni 3: Forma e bashkëpunimit**

Kjo marrëveshje lidhet si shprehje e gatishmërisë për bashkëpunim dhe vullnet të mirë të palëve, me mirëbesim dhe përpos përmbushjes së zotimeve nga marrëveshja (fushave të bashkëpunimit), palët nuk kanë asnjë detyrim tjetër ndaj njëra tjetrës.

### **Neni 4: Kohëzgjatja e marrëveshjes**

Marrëveshja ka kohëzgjatje të pacaktuar.

### **Neni 5: Hyrja në fuqi e marrëveshjes dhe format e ndërprerjes**

Marrëveshja hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga të dyja palët.

Marrëveshja mund të përfundojë më iniciativën e cilësdo palë me paralajmërim prej 2 muajsh.

**Neni 6:** Kjo marrëveshje është e shtypur dhe nënshkruar nga palët kontraktuese në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe secila palë do të mbajë nga 2 (dy) kopje origjinale.

Instituti për Hulumtime dhe Trajnime  
në Shkencat Mjekësore “Rezonanca”

Themeluesi:

Znj. Alida Idrizaj Gara

Kryesuesi:

Z. Eqrem Gara



“Oda e Farmacistëve të Kosovës” (OFK)

Kryetari i OFK:

Z. Ariani Jakupi





Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1 me nënparagrafin 4 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nr. 04/L-150, Oda e Farmacistëve të Kosovës (OFK) dhe Agjencia e Kosovës për Produktë dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) (në tekstin e mëtejshëm “Palët kontraktuese” në frymën e bashkëpunimit dhe ndihmës së ndërsjellë ndërinstitucionale, duke pasur parasysh veprimtarinë e përbashkët profesionale të cilën e rregullojnë, pajtohen të lidhin këtë:

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

### I. QËLLIMI

- Qëllimi i marrëveshjes është ngritja e bashkëpunimit në mes të Palëve kontraktuese në çështjet me interes të përbashkët dhe me theks të veçantë në shkëmbimin e të dhënave nën përgjegjësinë e tyre.
- Kjo marrëveshje përcakton kushtet nën të cilat palët mundësojnë shkëmbimin e të dhënave nga sistemet përkatëse dhe format tjera të bashkëpunimit.

### II. FUSHËVEPRIMI

- Fushëveprimi i kësaj marrëveshje është shkëmbimi i informacionit për farmacistët e licencuar nga OFK dhe të dhënat për barnatoret e licencuara, depot dhe sektoret tjere farmaceutike dhe stafin përgjegjës të tyre nga AKPPM.
- Ndihma reciproke profesionale në proceset e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm profesional.
- Bashkëpunimi në publikimet e ndryshme profesionale, informative, shkencore etj të realizuara përmes grupeve të përbashkëta profesionale.
- Bashkëpunimi për përgatitjen, zhvillimin e përbashkët dhe prezantimin e projekteve të përbashkëta kërkimore që kanë të bëjnë me tema dhe diskutime të interesit të ndërsjellë.
- Nxitjen e formave tjera të bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë/farmacisë të dakorduara nga udhëheqësit e institucioneve përkatëse.



### **III. MËNYRA E SHKËMBIMIT TË TË DHËNAVE DHE FORMA E REALIZIMIT TE BASHKËPUNIMIT**

- a) Shkëmbimi i të dhënave do të mundësohet në formë elektronike, përmes lidhjes së sistemeve me qasje vetëm nga përdorues të autorizuar apo përmes shkëmbimit me email zyrtar të institucioneve ose përmes personave të autorizuar nga udhëheqësit e palëve kontraktuese.
- b) Shkëmbimi i të dhënave bëhet në baza mujore/tremujore apo sa herë që kërkohet nga udhëheqësit e palëve kontraktuese ose personave të autorizuar nga ta.
- c) Palët mund të hartojnë udhëzues (procedurë) për shkëmbimin e të dhënave përmes të cilëve do të definohet lloji i të dhënave të cilat do të shkëmbehen në nivel teknik të informatave.
- d) Për aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm profesional do të krijohet komisione të veçanta nga OFK dhe AKPPM.

### **IV. ZOTIMET E OFK-SË DHE AKPPM-SË**

- a) Palët kontraktuese zotohen që të dhënat të cilat do të shfrytëzohen nga zyrtarët e saj do të përdoren vetëm për qëllime të kësaj marrëveshje dhe të njëjtat nuk do të shpërndahen për palë të tjera të paautorizuara.
- b) Palët kontraktuese pajtohet që të dhënat që janë në pronësi apo me të cilat disponon në lidhje me farmacistët e licencuar, barnatoret e licencuara dhe çështjet tjera nga fushëveprimi i kësaj marrëveshje ti vënë në dispozicion të njëra tjetrës në kohë reale jo më larg se 48 orë nga parashtrimi i kërkesës.
- c) Palët kontraktuese zotohen të njoftojnë pa vonesë njëra tjetrën në rast të ndryshimit të çfarëdo të dhëne të kërkuar si më lart për të dhënat e shkëmbyera.
- d) Palët kontraktuese zotohen se përpunimi dhe përdorimi i të dhënave personale nga ky memorandum duhet të bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
- e) Në rast të dyshimit për shkelje të sigurisë së informatave të çfarëdo forme, pala e dëmtuar duhet të njoftojë menjëherë palën tjetër dhe se të dy palët rezervojnë të drejtën për të ndërprerë përkohësisht shkëmbimin e të dhënave deri në sqarimin e situatës.



## V. PËRGJEGJËSIA

- a) Për qëllimet e këtij marrëveshje, çdo Palë është Kontraktuese e pavarur. Asnjë Palë nuk do të ketë autorizime për të bërë ndonjë deklaratë, përfaqësim ose angazhim të çfarëdo lloji, ose për të ndërmarrë ndonjë veprim i cili do të jetë detyrues për Palën tjetër, me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht në këtë marrëveshje ose të autorizuar me shkrim nga Pala tjetër.
- b) Secila Palë do të jetë përgjegjëse vetëm për mënyrën në të cilën ajo kryen pjesë të aktiviteteve të bashkëpunimit në bazë të kësaj Marrëveshje dhe/ose ndonjë marrëveshje tjetër. Pra, asnjëra palë nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë humbje, aksident, dëmtim që i është shkaktuar ose e ka shkaktuar pala tjetër, ose nga punonjësit, konsulentet ose nenkontraktoret e palës tjetër, në lidhje me ose si rezultat i bashkëpunimit për realizimin e aktiviteteve sipas kësaj Marrëveshjeje.

## VI. AFATI, NDËRPRERJA, AMANDAMENTIMI

- a) Kjo marrëveshje mbetet e vlefshme për një afat të pacaktuar.
- b) Marrëveshja mund të ndryshohet me pajtim të ndërsjellët me shkrim të palëve. Palët mundën, me shkëmbim letrash, të ndryshojnë ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ose të hyjnë në aranzhime plotësuese të përcaktuar me tej fushëveprimin e kësaj Marrëveshjeje.

## VII. ZBATIMI DHE HYRJA NË FUQI

- a) Palët nënshkruese u pajtuan që kjo Marrëveshje të fillojë së zbatuari nga data e nënshkrimit.
- b) Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, palët obligohen në zbatimin e plotë të saj.
- c) Kjo Marrëveshje është e nënshkruar nga personat e autorizuar dhe është e hartuar në dy (2) kopje të njëjta, nga një (1) kopje për secilën nga palët nënshkruese.

AKPPM  
Arian Ahmeti  
Ud. Kryeshef i AKPPM



Prishtinë  
01.07.2021

OFK  
Arianit Jakupi  
Kryetar i OFK



